



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR

Këshilli
Konsultativ



Procesverbali i Mbledhjes

Këshilli Konsultativ mes Qeverisë Qendrore dhe Qeverisë Vendore
Mbledhja e datës 18 shkurt 2025

Tabela e Përmbajtjes

Hapja e mbledhjes.....	1
1.Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.450, datë 26.07.2018 të Këshillit të Ministrave “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integrimit evropian, ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.....	2
2.“Raportim mbi ecurinë e zbatimit të Vendimit nr.1/2024 të Këshillit të Stabilitim dhe Asocimit midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Rajoneve (RoC).....	3
3. Dokumenti ”Mbi nevojën e hartimit të Rregullores së Brendshme të Këshillit Konsultativ si dhe analizës nga Projekti i BE-së, EU4GoodGovernance mbi nevojën e krijimit bazuar në standardet e Këshillit të Evropës dhe vendeve të BE-së“.....	4
4. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Turizmit 2025-2030 dhe planit të veprimit”.....	5
5.“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 784, datë 18.12.2024 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe zhvillimin e zonave aeroportuale”.....	6
Shtojcë: Të pranishëm	5

Hapja e mbledhjes

Në zbatim të VKM nr. 244, datë 17.4.2024 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjes Vendore”, u mbajt mbledhja e parë më datë 18 shkurt për vitin 2025, Pallati i Kongreseve, Salla Albanologjia, Tiranë. Në mbledhje merrnin pjesë anëtarët e Këshillit Konsultativ, përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe donatorë të huaj. Mbledhja u kryesua nga bashkëkryetarët e Këshillit Konsultativ, *Z. Arbjan Mazniku, Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Z. Aldrin Dalipi, Kryetar Këshillit të Qarkut Tiranë, Bashkëkryetar i këshillit konsultativ* i cili në fjalën e tij përshëndetëse falenderoi shoqatat dhe përfaqësuesit e NJVV-ve.

PROJEKTAKTE TË KONSULTUARA

1. **Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.450, datë 26.07.2018 të Këshillit të Ministrave “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritimit evropian, ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”**
2. **“Raportim mbi ecurinë e zbatimit të Vendimit nr.1/2024 të Këshillit të Stabilitimit dhe Asocimit midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Rajoneve (RoC)”**
3. **Dokumenti “Mbi nevojën e hartimit të Rregullores së Brendshme të Këshillit Konsultativ si dhe analizës nga Projekti i BE-së, EU4GoodGovernance mbi nevojën e krijimit bazuar në standardet e Këshillit të Evropës dhe vendeve të BE-së”**

Z. Arbjan Mazniku Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor theksoi pasjen e një mekanizmi më të qënësishëm për procesin e integritimit evropian duke patur parasysh që kapitulli 22 lidhet ngushtësisht me mënyrën se si duhet të bashkërendojmë punën mes bashkive dhe qeverisjes qendrore. Vkm nr 450 është një akt i rëndësishëm ku presim impaktin e bashkive dhe të kolegëve. Pjesa e madhe e negocimit do të ndodhë nga skuadra e negocimit dhe është e rëndësishme që në fazën e parë të negocimit bashkitë të jenë pjesë e këtij procesi në mënyrë që të japin një feedback të qënësishëm. Njësitë e integritimit të kenë një rol aktiv se çfare negociohet dhe nëse ka një propozim nga ana e bashkive.

Në lidhje me aktin e dytë Shqipëria është pjesë e komitetit të rajoneve e cila bashkërendon punën dhe në vjeshtë është caktimi i mekanizmave të përbashkët mes bashkive dhe komitetit të rajoneve. Akti i tretë është nevoja për të pasur një rregullore të posaçme të këtij këshilli konsultativ si dhe krijimin e komisioneve ad hoc bazuar në standardet e Këshillit të Evropës. Për çështje apo problematika të caktuara të ketë një komision dhe të kemi një rregullore se si ai komision vendoset në punë.

Znj. Marsela Maçi, Drejtor për Integritimi Evropian, Agjencia për Mbeshtetjen e Vetëqeverisjes

Vendore Vkm ka te bëjë me punën e bashkive me pushtetin qendror si dhe strukturon punën e bashkive në rolin e procesit në aderimin në Bashkimin Evropian. Akti përcakton dy linja komunikimi atë të bashkive me nivelin qendror. Linja e parë ka të bëjë me bashkërendimin e bashkive me negociatorin si dhe gatishmëria e bashkive kundrejt negociatorit si kontributin e tyre apo dhënien e informacionit. Linja e dytë është specifike ku në kapitulli 22 i detikohet zhvillimit lokal në aspektin territorial, social, Akti strukturon strukturat e integritetit dhe bashkërendon punën me drejtoritë e tjera të bashkisë.

Z.Elton Stafa, Ekspert, projekti Nalas theksoi se në aktin e dytë në këtë analizë kemi ndryshuar pikat e forta në ndërmarrjen e komisioneve ad hoc për të përforcuar dialogun ndërqeveritar. Pratika të tjera janë relevante si ato evropiane me komisione këshillimore. Kemi krijuar elementin bërthamë si koncept. Parimi bazë është Karta Evropiane për qeverisjen vendore ku neni 6 citon që autoritetet vendore duhet të konsultohen në çdo fushë dhe si praktike konsultimi kryhet nga shoqatat e bashkive. Termat sigurojnë një dialog efektiv që të kenë kohën të formulojnë këto akte në fazën paraprake të projektvendimit. Rezoluta e Këshillit Evropian nga 2004 e në vijim përcakton detyrime për kuadrin rregullator për konsultimet ndërqeveritare për forcimin e bashkive më efektive.

Roli aktiv i NJVV është njohja institucionale e tyre në konsultim bazuar në kuadrin e konsultimit të hershëm mes bashkive dhe ministrive të linjës në mënyrë të rregullt. Këto rezoluta përbajnë mekanizma për rolin e ministrive, bashkive dhe shoqatave. Ankimi është mekanizëm për njërën nga palët kur konsultimi nuk është i qartë. Parimi i partneritetit konsiston në bashkëpunimin e NJVV me qeverinë. Rekomandimet e rëndësishme për komisionet është që këto të kenë në objektivin e tyre bashkëpunimin e hershëm si dhe dhënien e komenteve të tyre. Roli i ndërkomisioneve është rishikimi i iniciativave ligjore.

Z. Ermal Elezi argumentoi se në vkm 244 ngrihen komisionet grupe juridike në mënyrë të bëjnë dhe propozime të projektvendime dhe si t'i financojmë ato për fusha të ndryshme.

Z.Fran Brahim, Drejtor për Financat Vendore, Ministria e Financave argumentoi se të gjithë kapitujt janë crosscutting me NJVV. U bëjnë thirrje donatorëve për gjëra konkrete për mbështetje me komente të sakta dhe konkrete. Strukturat në bashki duhet të jenë konkrete dhe të bëhet një orientim financiar.

Z. Mazniku theksoi se kapitujt kanë impakt për bashkitë të cilat duhet të kenë njerëz të specializuar për të pasur një opinion të hershëm për projektvendimet. Shoqatat të koordinojnë punën për kërkesat që do të kenë bashkitë. Duhet të përmbushim procesin e negocimit brenda 2027 dhe bashkitë të kenë angazhim për këtë çështje. Kërkohej angazhim nga bashkitë për kapitujt.

Znj. Adelina Farrici argumentoi se në këtë periudhë intensive për procesin e integritetit bashkitë kanë probleme në njohjen e përgjegjësisë në këtë proces. Duhet të krijohen struktura fikse dhe ndihmë nga donatorët, duhet të shikohet krahas integritetit dhe njësia e performancës e cila mbledh të dhënat nga departamentet e ndryshme dhe duhet të përfshihet dhe roli i shoqatës i cili është kyç në ngritjen e forcimin e njësive të integritetit për rolin e tyre dhe lidhshirin bashkiak.

Roli i shoqatës të futet në këtë projektvendim.

Për sa i përket komisioneve teknike në kemi qenë pjesë e tryezave teknike por, mendimet duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe shoqata duhet të përzgjedhë këto ekspertë për të sjellë mendim gjithëpërfshirës. Për vkm për Komitetin e Rajoneve, znj. Farricu u shpreh se SHAV i ka dërguar mendimet me shkresë zyrtare pranë MSHPV.

Z. Ervis Moçka shprehu dakordësinë me ngritjen e komisioneve ad hoc. Sa i përket Komitetit të

Rajoneve, u shpreh se SHKQSH përfaqësohet me dy anëtarë. Shkresa zyrtare me emrat e anëtarëve është dërguar pranë MSHPV.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t'i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ

4. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Turizmit 2025-2030 dhe planit të veprimit”

Znj. Ilva Gjuzi, Zëvendësministër, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit prezantoi aktin duke theksuar se është formuluar strategjia deri në vitin 2030. Targeti i turistëve është arritur në bashkëpunim me Giz dhe duhet të bëhemi pjesë e konkurimit me klimë të qëndrueshme. Kemi objektiva sasior për rritjen e qëndrimeve dhe shtrija e këtij zhvillimi kudo në bashki dhe kohëzgjatje të shtrihet deri në 6 netë në cilësi dhe sasi. Rritja e produkteve dhe cilësisë është synimi i strategjisë.

Duhet të formalizohet industria e turizmit, niveli i saj mbetet i lartë,

Forca e kualifikuar mbetet një sfidë e madhe dhe mënyra tjetër është futja e ekonomisë formale në njësitë akomoduese.

Përthithja e investimeve të huaja cilësore dhe rishikimi i kuadrit ligjor i turizmit.

Menaxhimi i destinacioneve është i rëndësishëm, ku sot kemi vetëm një OjF për menaxhimin e destinacioneve, produkteve turistike që janë elementë të rëndësishëm për zhvillimin e tyre për të ruajtur vlerat tona. Aspekti i marketingut është bërë një punë e mirë.

Ngritja e kapaciteve në industrinë e turizmit si dhe ekspertëve të qeverisë dhe bashkive për të çuar përpara këtë vision.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t'i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ

5. “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 784, datë 18.12.2024 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe zhvillimin e zonave aeroportuale”

Z. Enea Rrapaj nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë theksoi se akti përcakton rregulla specifike dhe rolin e çdo institucioni duke përcaktuar zonat e mbrojtura të aeroporteve.

Zona “A” është zona e cila shtrihet në një rreze prej 2 (dy) kilometra nga pika e referimit të aeroportit.

Zona “B” është zona e cila shtrihet në një rreze prej 2 (dy) kilometra nga përfundimi i Zonës “A”.

Zona “C” është zona e cila shtrihet në një rreze prej 11 (njëmbëdhjetë) kilometra nga përfundimi i Zonës “B”

Leja për zhvillim apo ndërtim në Zonën “A” merret pranë Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (në vijim “KKTU”), sipas parashikimeve në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.

Pika 4 shtohen;

Leja për zhvillim apo ndërtim në Zonën “B” merret pranë Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (në vijim “KKTU”

Në Zonën “C”, për objektet që janë 30 metra lartësi nga toka ose më shumë, leja për zhvillim apo ndërtim merret pranë Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit

Akti ka fuqi prapaveruese nga 2024

Nga bashkia Tiranë u theksua që pika13 duhet të përkohet me pikën 6.

Z. Enea Rrapaj argumentoi se vendimi bazë ka një rreze prej 15 km dhe leja merret nga KKTU dhe për pikën 13 te ndiqet e njëjta procedurë si për objektet fillestare dhe ndryshimet.

Z.Maksim Ethemaj, Drejtor, AAC theksoi se vendimi është detyrim ligjor për anëtarësim dhe jemi në fazën e një aplikimi për të rritur efikasitetin e aplikimeve dhe AZHT do ketë akses dhe pjesë e vendimit që dalin jashtë rregullores nr. 408 nuk duhet abuzuar dhe bashkitë për lejet të mos tejkalojnë aksesin e tyre.

Z. Mocka shtyroi pyetjen mbi pikën e referimit të aeroportit

Z.Maksim Ethemaj theksoi se zona e referimit është në pistë dhe çdo kalkulim merret pistë.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t’i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ

10. Mbyllja e mbledhjes

Z Aldrin Dalipi e mbylli mbledhjen duke falenderuar zëvendësministrat, kryetarët e bashkive dhe pjesëmarrësit nga bashkitë, si dhe shprehu gadishmërinë për të mirëpritur komentet/sugjerimet për projektvendimet e konsultuara.

Shtojca 1: Të pranishëm në mbledhje

Anëtarët e Këshillit Konsultativ			
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni	Institucioni/Organizata
1	Arbjan Mazniku	Ministër Shteti për Pushtetin Vendor	Kryeministria

2	Aldrin Dalipi	Kryetar	Këshilli i Qarkut Tiranë
4	Denada Seferi	Zv/ministër	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale
9	Fran Brahim	Drejtor	Financat Vendore
10	Ervis Moçka	Kryetar	SHKQSH, Kryetar i Këshillit të Qarkut Vlorë
13	Alma Selami	Kryetar	SHKQSH, Këshilli i Qarkut Dibër

Shënim: Materialet e diskutuara në mbledhjen e datës 18 shkurt 2025 mund t'i gjeni në linkun e mëposhtëm;

<https://qeverisjavendore.gov.al/keshlli-konsultativ/mbledhjet-e-keshillit-konsultativ/viti-2025/mbledhja-e-radhes-shkurt/>

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ

E-mail: keshilli.konsultativ@amvv.gov.al

Adresa: Bulevardi “Zhan d’Ark, ish- Shtëpia e Oficerave, Kati i VII”, Tiranë, Shqipëri.